

Në bazë të Programit për aktivitetet në fushën e sportit dhe të rinjve në qytetin e Shkupit për vitin 2024 (Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit numër 3/24), Qyteti i Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE

për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e programeve, projekteve, aktiviteteve programore dhe manifestimeve për të rinjtë me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2024

1. Lënda e thirrjes publike

1.1. Lënda e thirrjes publike është ndarja e mjeteve financiare për realizimin e programeve, projekteve, aktiviteteve programore dhe manifestimeve për të rinjtë në interes të Qytetit të Shkupit për vitin 2024, me qëllim të përkrahjes së të rinjve dhe avancimit të pozitës së tyre në shoqëri.

1.2. Mjetet nga pika 1.1. janë të siguruara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2024.

1.3. Ndarja e mjeteve financiare për programet, projektet, aktivitetet programore dhe manifestimeve për të rinjtë në interes të Qytetit të Shkupit për vitin 2024, përcaktohet me kushte dhe kriteret të veçanta, të cilat janë pjesë përbërëse e Rregullores për mënyrën, kushtet dhe procedurën për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e programeve, projekteve, aktiviteteve programore dhe manifestimeve për të rinjtë në interes të Qytetit të Shkupit nr. 08-3796/1 të datës 11.04.2024, që janë pjesë përbërëse e kësaj thirrjeje publike.

2. E drejta për pjesëmarrje në thirrjen publike

Të drejtën e pjesëmarrjes në thirrjen publike e kanë shoqatat civile, organizatat jo qeveritare, fondacionet dhe personat tjerë juridik (në tekstin e mëtejme: personat juridikë), të regjistruar në Regjistrin Qendror me seli në Shkup dhe personat fizik – të rinjtë e talentuar individ banorë të qytetit të Shkupit, të moshës nga 15 – 29 vjeçar të cilët do t'i plotësojnë kriteret e Rregullores dhe që do të dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm.

3. Përshkrimi i programeve, projekteve, aktiviteteve programore dhe i manifestimeve

Në pajtim me Programin për aktivitete në fushën e sportit dhe rinisë në qytetin e Shkupit për vitin 2024 ("Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 3/24), ndahen mjetet financiare për realizimin e programeve, projekteve, aktiviteteve dhe manifestimeve programore, në fushat vijuese:

- 3.1. Inkurajimi i të rinjve për pjesëmarrje aktive në shoqëri përmes afirmimit dhe mbështetjes së aktiviteteve rinore, punës rinore dhe edukimit joformal në territorin e qytetit të Shkupit;
- 3.2. Inkurajimi i lidhjeve, shoqatave dhe formave të tjera të asociimit për të marrë pjesë në krijimin dhe zbatimin e politikës rinore në Shkup, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve të shoqatave dhe organizatave rinore në territorin e qytetit të Shkupit;
- 3.3. Sigurimi i kushteve për shfrytëzim aktiv dhe cilësor të kohës së lirë për të rinjtë;
- 3.4. Inkurajimi i të rinjve për të krijuar ide në fushën e teknologjisë së informacionit;
- 3.5. Inkurajimi i aktiviteteve vullnetare mes të rinjve dhe përvoja organizative në panairët e sipërmarrësisë, organizimi i "IT MITAP (IT MEETUP) HAKATONI" - ngjarje për zhvillimin e inovacioneve (mjete specifike, metoda, aktivitete, qasje dhe modele për të punuar me të rinjtë) për përfshirje dhe pjesëmarrje aktive të të rinjve. dhe mbështetje për zhvillimin e tyre personal dhe social, si dhe organizimin e seminareve dhe edukimeve për të rinjtë;
- 3.6. Nxitja e aktiviteteve në fushën e kulturës dhe artit të të rinjve në territorin e qytetit të Shkupit;
- 3.7. Inkurajimi i të rinjve për të marrë pjesë në aktivitete sportive dhe rekreative me theks në kultivimin e shprehive të jetesës së shëndetshme;
- 3.8. Mbështetja e aktiviteteve dhe projekteve për mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimin hapësinor në Shkup;
- 3.9. Mbështetje për aktivitetet e integritit dhe përfshirjen aktive të "NEET (NEET) grupit të të rinjve", me qëllim uljen e papunësisë tek të rinjtë, forcimin dhe rritëzimin e grupit të të rinjve NEET, përmes rritjes së bashkëpunimit të sektorit të të rinjve me institucione të ndryshme në nivel kombëtar dhe lokal.

4. Kushtet dhe kriteret e përgjithshme

- 4.1. Aplikantët janë të detyruar të paraqesin aplikimin për fushat e përcaktuara nga pika 3 e thirrjes publike.
- 4.2. Aplikacionet e dorëzuara duhet ti plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të pikësimit që janë pjesë përbërëse e Rregullores, të cilat do të publikohen në faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit. (www.skopje.gov.mk).
- 4.3. Në procedurën për ndarjen e mjeteve financiare nga Programi për aktivitete nga sfera e sportit dhe rinisë në qytetin e Shkupit për vitin 2024, do të pranohen ato programe, projekte, aktivitete programore dhe manifestime të cilat sipas kriterëve dhe listave të pikëve, do të sigurojë të paktën **60** pikë.

5. Mënyra e paraqitjes dhe dokumentacioni i detyrueshëm

Aplikantët, personat juridik dhe personat fizik – të rinjtë e talentuar si individ, për aplikim në Thirrjen Publike, janë të detyruar të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

5.1. Personat juridik duhet të dorëzojnë:

- a) Aplikacioni/fletë paraqitja e plotësuar (aplikacioni do të publikohet në ueb faqen e Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);
- b) Kopja e aktvendimit për regjistrim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- c) Kopja e gjendjes aktuale të subjektit për veprimtari të regjistruar jo më e vjetër se 6 muaj, e lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- ç) Vërtetim nga banka për hapjen e një llogarie aktive të transaksioni;
- d) Lista referuese e programeve, projekteve dhe aktiviteteve programore dhe e manifestimeve të realizuara më parë, gjatë tre viteve të fundit;

5.2. Personat fizik – individët e talentuar duhet të dorëzojnë:

- a) Aplikacioni/fletë paraqitja e plotësuar (aplikacioni do të publikohet në ueb faqen e Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);
- b) Biografi të shkurtër dhe CV të aplikantit;
- c) Dëshmi se është banorë i qytetit të Shkupit;
- ç) Kopje e fletës së parme të llogarisë së transaksionit (që është personale e aplikantit, jo e autorizuar nga ana e personit të tretë, dhe nëse aplikanti është person i moshës së mitur, llogaria e transaksionit duhet të jetë ekskluzivisht personale e aplikuesit të autorizuar nga ana e prindit / kujdestarit).

6. Afati dhe mënyra e dorëzimit të aplikacioneve

6.1. Thirrja publike publikohet në ueb faqen e Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk),

6.2. Thirrja publike do të zgjasë 15 ditë, llogaritur nga dita e shpalljes.

6.3. Dokumentacionin e nevojshëm, në zarf të mbyllur, aplikantët e dorëzojnë deri te Komisioni përmes Arkivit të Qytetit të Shkupit (baraka 16), me shënimin: “Deri te Sektori për veprimtari publike - Komisioni për realizimin e procedurës për ndarjen e mjeteve financiare për programet, projektet, aktivitetet programore dhe manifestimet për të rinjtë me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2024”.

6.4. Zarfi nuk duhet të përmbajë asnjë shenjë që mund të identifikojë aplikantin.

6.5. Aplikacioni me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet në një kopje origjinale, të plotësuar në mënyrë elektronike, e nënshkruar dhe e vërtetuar/vulosur nga personi përgjegjës i aplikantit.

7. Mënyra e realizimit të thirrjes publike

7.1. Me qëllim të përcaktimit të përmbushjes së kriterëve nga Rregullorja për mënyrën, kushtet dhe procedurën për ndarjen e mjeteve financiare, Kryetari i Qytetit të Shkupit themelon Komisionin për zbatimin e procedurës për ndarjen e mjeteve financiare për programet, projektet, aktivitetet programore dhe manifestimet për të rinjtë me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2024.

7.2. Për aplikimet që janë të plota, të dorëzuara në kohë dhe të cilat i plotësojnë kriteret e dhëna si shtojcë e thirrjes, Komisioni dorëzon propozimin deri te Kryetari i Qytetit për ndarjen e mjeteve financiare për aplikantët.

7.3. Kryetari i Qytetit të Shkupit, sipas propozimit të Komisionit, miraton Aktvendim për ndarjen e mjeteve financiare.

7.4. Komisioni nuk do të shqyrtojë aplikimet e dorëzuara me vonesë.

7.5. Aplikacionet e plotësuara me dorë nuk do të merren fare në konsideratë.

7.6. Komisioni do ti njoftojë aplikantët, aplikimet e të cilëve janë pranuar dhe aplikantët, aplikimet e të cilëve janë refuzuar si të paplota, të dorëzuara me vonesë dhe që nuk i plotësojnë kriteret e Rregullores.

Mjetet e përcaktuara për financim të programeve, projekteve, aktivitetëve programore dhe manifestimeve nga fusha e të rinjve me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2024, do të paguhen pas përfundimit të procesit zgjedhor për vitin 2024.

Për informacione plotësuese:

Informacione plotësuese mund të sigurohen në Sektorin për veprimtari publike – seksioni për sport dhe të rinj, në telefonat: 3297-238 dhe 3297-320.

QYTETI I SHKUPIT